

Izmit DURMISHI

KONTRIBUTI I VOJISLLAV DANÇETOVIIQIT PËR PRAPASHTESAT E EMRAVE TË SHQIPES ME KUPTIM ZVOGËLUES

UDC 811.18'373.611

Abstrakti: *Kumtesa që po shqyrtojmë ka të bëjë me kontributin e albanologëve të huaj për gjuhën shqipe, e veçanërisht me prurjet e Vojisllav Dançetoviqit për prapashtesat e emrave të shqipes me kuptim zvogëlimi, apo siç e quan ai “sufiksi diminutiv”.*

Çështja e fjalëformimit të shqipes është trajtuar nga gjuhëtarë të huaj dhe vendës edhe në të kaluarën. Për trajtimin e temave tilla, si dhe për shumë çështje të tjera albanologjike, mjafton të rikujtojmë sidomos kontributin e Gustav Majerit me veprën “Studime shqiptare”, Vjenë, 1883, Maksimilian Lambercit me veprën “Studime dialektore italo-shqiptare”, Getingen, 1924, Eqrem Çabejt me dorëshkrimin e veprës “Studime italo-shqiptare”, Vjenë, 1933, Gjergj Pekmezit me veprën “Gramatika e gjuhës shqipe”, Vjenë, 1908, si dhe shumë të tjerë, të cilët, kush më shumë e kush më pak, kontribuan në fushën e fjalëformimit dhe në fusha të tjera të dijes albanologjike. Përpos studimit të shqipes nga studiuesit vendës, prurjet për shqipen nga të huajt vazhduan deri ditët e sotme. Kësaj radhe veçuan ta shtjellojmë kontributin e Vojsllav Dançetoviqit për sufiksën diminutiv të emrave të shqipes, pasi, siç ka vënë në dukje edhe vet autori, ky segment i fjalëformimit ishte trajtuar fare pak deri në vitet e 60-ta, ndoshta jo mjaftueshëm edhe sot.

Fjalët kyçe: *kontribut, prapashtesa, diminutiv, gjuhë, trajtim*

THE CONTRIBUTION OF VOJISLAV DANCETOVIQ FOR THE DIMINUTIVE SUFFIXES TO THE ALBANIAN NAMES

Abstract: *This research we are considering is about the contribution of foreign albanologists to the Albanian language and in particular to Vojislav Dancetoviq’s input on the suffixes of the Albanian nouns with diminishing meaning or as he calls “diminutive suffixes”.*

The issue of the Albanian word formation has been dealt with by foreign and local researchers throughout the times. In addressing such topics, as well as many other Albanian issues, it is important to recall in particular Gustav Meyer’s contribution to the work “Albanian Studies”, Vienna, 1883, by Maximilian Lambreci to the work “Albanian – Italian Dialectical Studies”, Getingen, 1924, Eqrem Çabej with the manuscript of the work “Italian – Albanian Studies”, Vienna, 1933, Gjergj Pekmezi with the work “Grammar of the Albanian Language”, Vienna, 1908, as well as many others who contributed more or less in the field of word formation and other areas of Albanian Studies.

In addition to the study of Albanian Language by local scholars, the contribution to this from foreigners continued to this day. This time, we have chosen to elaborate on Voislav Dancetoviq contribution to the diminutive suffix of the Albanian nouns, as the author himself stated out, this segment of the word formation was treated very little until the 1960s, perhaps even today.

Keywords: *contribution, suffixes, diminutive, language, treated*

Për ta përforcuar idenë se kjo temë nuk ishte trajtuar sa duhet, autori në vazhdim pohon se edhe albanologët e huaj më në zë, siç ishte Gustav Majeri¹, e kishin trajtuar çështjen e prapashtesave të shqipes me kuptim zvogëlues në mënyrë të përgjithshme. Bile ai përmend se Majeri kishte trajtuar vetëm prapashtesën –**th** për formimin e emrave të gjinisë mashkullore, dhe - **zë (-ëz)** për formimin e emrave të gjinisë femërore. Kështu ndodhte edhe me veprën e Lambercit dhe gjuhëtarëve të tjerë.

Një trajtim më të plotë prapashtesave të shqipes me kuptim zvogëlues nga studiuesit e huaj u ka bërë Dançetoviqi në vitet e 60 të shek. XX. Që në fillim të punimit të tij kishte pohuar një çështje të rëndësishme që më parë kishte përmendur sipërfaqësisht edhe Majeri, se: dy prapashtesat e shqipes – **th** dhe –**zë (-ëz)** janë të burimit të shqipes dhe të pëhapura në të dy dialektet e gjuhës sonë. Ai më tej pohon po kështu se “fakti që sufiksi – **zë** ka depërtuar edhe në gjuhën rumune është një dëshmi e vjetërsisë së tij të lashtë”.

Shqipja, duke pasur kontakte të pandërprera me gjuhët e tjera të Ballkanit, përpos që ka dhënë elemente gjuhësore, ka përvetësuar një numër të madh sufiksash diminutivë. Huazimet më të shumta të kësaj natyre janë me origjinë sllave, rumune dhe turke.

Autori në vazhdim është përpjekur të sqarojë edhe motivin psikologjik të emrave me anën e prapashtesave të zvogëlimit, duke na rrëfyer tre motive bazë të kuptimit për ta: 1. i pari, emrat me sufiks diminutiv të tillë rrjedhin nga diçka **a)** “e vocërr”, **b)** “e dashur ose e shtrenjtë” dhe **c)** “e re”. P.sh. fjala *derrkuc* do të thotë “*thi i vogël*”. Pasi është **i ri** dhe **i vogël**, atëherë është edhe **i dashur**. Siç duket, dukurinë e formimit të emrave me prapashtesa zvogëluese e lidh edhe me faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë. Profesor Gjovalin Shkurtaç² kur bën fjalë për zbunimin apo përkëdhelien në gjuhë, jep arsyet e kësaj dukurie gjuhësore: “e zbunojmë dikë për ta afruar, për ta mikluar, për t’i shprehur afërsinë, dashurinë, adhurimin etj.” Zbunim dhe zbunoj, siç dihet, kanë si rrënjë mbiemrin (i, e) *butë*, prej nga dalin foljet *zbut*, *zbunoj* (< e zbutnoj) me kuptimin “*marr me të mirë, përkëdhel*” Pra, kur kemi parasysh dukurinë e zbunimit apo përkëdhelies së emrave, duhet pasur parasysh disa rrethana jashtëgjuhësore: shoqërore, miqësore, familjare etj. Pra, ajo që na shtynë t’i themi shumicën e emrave të shqipes me kuptim zvogëlues është motivi i gërshetuar nga faktorët e ndryshëm gjuhësorë e jashtëgjuhësor që përmendura më sipër, e që kanë të bëjnë edhe me psikologjinë e njeriut.

Me anën e prapashtesave të zvogëlimit janë formuar edhe disa emra të sendeve, si p.sh.: *fjalor-th* (fjalor i vogël), *drrasë-z*, (dërrasë e vogël) etj.

1. Patronimet hipokoristike dhe emrat e vendeve

Te fjalët hipokoristike të shqipes me sufiks diminutiv, vjen në shprehje tipari cilësues “i dashur”. P.sh.: *nano* = nanë e shtrenjtë, e dashur, *nënoçkë*; *vllalo* = “*vllath*”, vëlla i dashur i shtrenjtë etj. Te fjalët *nano*, *vllalo* e tjera të ngjajshme, prapashtesën –**o**, autori e shpjegon si formë të re që përdoret në të folmet shqipe që kufizohen me gjuhët sllave (sërbishten-maqedonishten). Më tej shpjegon se “ka gjasa që është marrë si prapashtesë e gatshme e vokativit (*nano*, *najo*)” duke përfunduar se në të folmet shqipe të Kosovës dhe Maqedonisë formohen emrat me kuptim patronimik dhe hipokoristik. Kështu, hipokoristika ka zënë një vend të rëndësishëm në formimin e patronimeve, si: *Paluc* (Pal), *Kostaq* (Kostë), *Kolec* (prej rrënjorit diminutiv Kolë, që rrjedh prej Nikollë), *Demush* (prej rrënjorit diminutiv Demë që rrjedh prej Adem), *Mikleç* (nga Mikel), *Bec* (nga Bekë-a, Bekim, *Ndrec* (nga Andre, Ndre) etj. Emra vendesh: *Bec*, *Lisec*, *Dolec*, *Nakolec* (Dy vendet e fundit ndodhen pranë liqenit

¹ Gustav Majer, Studime shqiptare, Vjenë, 1883.

² Gjovalin Shkurtaç, Etnografi e të folurit të shqipes, Tiranë, 2004, f. 159

të Prespës), *Lepenec*, *Strokovec* (majë mali prej 1480m. lartësi në Lunxhëri). Patronimikat pa prapashtesa me kuptim zvogëlues (pa sufiks diminutiv) formohen nga emra të përveçëm njerëzish në disa mënyra:

a) duke u marrë për bazë pjesa e parë e emrit, si: *Rustë* (hip. Nga Rustem), *Shabe* (hip. nga Shaban), *Nur* (hip. nga Nuredin) etj.,

b) duke u marrë për bazë pjesa e fundit e emrit, si: *Dik* (hip. nga Sadik), *Baz* (hip. nga Abaz), *Xhep* (hip. nga Rexhep), *Met* (hip. nga Ismet) etj.

c) duke marrë për bazë herë pjesën e parë të emrit, herë pjesën e dytë të tij dhe duke u bërë patronimika vetëm me to, si p.sh.: *Alë*, *Lush* (nga Alush), *Osë*, *Man* (nga Osman); *Alë*, *Lil* (nga Halil) etj.

2. Ndërrimi i gjinisë tek emrat me kuptim zvogëlues

Në gjuhën shqipe formohen emrat me kuptim zvogëlues të dy gjinive, gjinisë mashkullore dhe asaj femërore me prapashtesa të veçanata për secilën gjini. P.sh.: në gjininë mashkullore thuhet *derkuc-i*, në gjininë femërore thuhet *derkucë-a*; *pëllumç-i*¹ “pëllumb i vogël” gjinia mashkullore, *pëllumçe-ja* “pëllumbeshë e vogë” gj.f. ; *vocërrak-u* gj.m., *vocërrak-eja* gj.f. etj.

3. Kuptimi zvogëlues i mbiemrave dhe ndajfoljeve

Kuptim zvogëlues mund të marrin kryesisht edhe pjesët e tjera të ligjëratës, siç janë mbiemrat e ndajfoljet. E kjo ndodh si zakonisht pasi të gjithë mbiemrat e panyjshëm në gjuhën shqipe mund të kenë paralelisht funksionin dhe kuptimin e emrit, mbiemrit dhe të ndajfoljes. P.sh. kur përmendim emrin diminutiv *bardhok*, mund të nënkuptojmë edhe kuptimin mbiemëror “i bardhë” dhe atë ndajfoljor “bardhë”. Në vazhdim po japim edhe ca shembuj të tjerë të kësaj natyre me prapashtesa të tjera zvogëlimi, si: *-acak*, *-ak*, *-aman*, *-an*: *frikacak*, *rrenacak*, *trashaman*, *çalaman*, *zeshkan* etj. Përpos tjerash, siç përmendëm më sipër, kuptim diminutiv mund të marrë edhe ndajfolja. Kështu p.sh. nga ndajfolja **pak** kemi edhe trajtën e saj me kuptim zvogëlimi **pakëz** që ka një përdorim të gjerë sot.

4. Emra bimësh e shtazësh me prapashtesë zvogëlimi

Emrat e bimëve dhe shtazëve përbëjnë një sfond të pasur leksikor të thesarit burimor të shqipes. Autori ka trajtuar edhe mjaft emra të botës bimërore e shtazore dhe emra sendesh me kuptim diminutiv. Sa për ilustrim po përmendim sufiksdiminutiv *-zë* që gjason në të folme me prapashtesën *-ës*, *-cë*, si p.sh. *furkës*, *furkëz* “furkë që mban hardhitë a pemët e ngarkuara me kokrra”. Po kështu edhe një numër i madh bimësh e shtazësh marrin emra me kuptim zvogëlues, si: *krekez*, *furkëz*, *zogës* etj. Prapashtesa zvogëluuese – *zë* formon kryesisht emra të gjinisë femërore ishte shprehur edhe Jokli, por kjo nuk nënkupton se ky sufiks nuk formon dhe ndonji lloj tjetër fjalësh.

Autori në vazhdim është orvatur të shpjegojë çështjen e emrave diminutivë, duke saktësuar rëndësinë e strukturës së emrave të tillë, edhe atë: rrënjën + prapashtesën. Në këtë pikëpamje kemi të formuar emrin me kuptim zvogëlimi *bimëzë* nga rrënja *bimë* + prapashtesa *-zë*, *pemëzë* nga rrënja *pemë* + prapashtesa *-zë*, *arnica* nga *arnë* + *icë*, *zogth* nga *zog* + *-th*, *deriçkë* nga *derë* + *içkë*, *derrriçkë* + nga *derr* + *içkë* etj.

¹ Dr. Vojislav Dançetović, Sufiksi diminutiv i emrave të gjuhës shqipe, Prishtinë, 1960, f.11

Nga bota bimore dhe shtazore me sufiksin *-zë* autori ka nënvizuar edhe emrat e tipit: *mollëzë* - mollë evogël (dhe figurativisht: mollëza e gabzherit në fyt “mollëza e Adamit”), *pjeshkëz* – pjeshkë e vogël, *lejthizë* nga lejthi; *burklës*, *buklëz* nga “bukël – bukla”; emra insektesh e zogjesh: *bletëz* nga bletë; *zogëz* nga zog etj.

Te emrat e shtazëve, të cilët, krahas emrave të bimëve janë më të shumtë në numër gjejmë këtë dukuri të formimit të trajtave të dyta të emrave, që janë gjallë edhe sot e gjithë ditën dhe që shfaqen edhe në të folurit e shqiptarëve. Si të tillë po përmendim: *kalush* (FSH) “kalë i vogël”, *dhëlpërush*, *dhëlpërushkë* (Korçë, Gostivar), “dhëlpër e vogël”, *lepurushkë* (FSH) “klysh lepur”, *minuk-u*¹(FGJSSH) “mi i vogël”, *thiçkë* (Korçë): *thi* + *çkë* “thikë e vogël”; *thi* + *çkë* “thi i vogël” etj. Si emra të tillë diminutive mund të përmendim edhe një numër të konsiderueshëm emrash të shtazëve sipas ngjyrës, siç janë: *bardhashi-i e.m.*, *shm. -ë* (FGJSSH) “kalë i bardhë”; cjan i bardhë; pëllumb i bardhë”; *fem. -e*; *kuqash-i*, *em. -i* “cjan i kuq”, *thimash - i* em. (FGJSSH) “cjan i thimë, *korbash - i* em. (FGJSSH) “cjan i zi”, *larec* (Dibër) “thi i vogël e i larëm, cjan” etj., ku rrënja e emrit ose mbiemri së bashku me sufiksin diminutiv formon zakonisht hipokoristikën, i cili ka edhe kuptim mbiemri me kuptim diminutiv.

Trajta të dyta emrash të tjerë me prapashtesa zvogëlimi paraqesin edhe emrat e qenieve të tjera të gjalla, si: *pëllumçe*, *pëllumkë*, (Korçë) *pëllumbeshë* (Çegran - Gostivar) nga pëllumb; *korbçe* (Korçë) nga korb etj.

Pa u ndalur në detaje, në vazhdim po japim disa forma fjalësh që janë formuar me prapashtesa zvogëlimi që ka trajtuar autori dhe që përdoren edhe sot.

Prapashtesa *-ac* që sipas autorit është huazuar nga sllsvishtjja, kryesisht në shqipen shërben për të formuar fjalë me kuptim të ri leksikor, por në disa raste ajo shërben edhe për të krijuar fjalë me kuptim zvogëlimi (diminutive). Si p.sh. nga rrënja e foljes *përtoj*, *me përtue – me pritue* (FGJSSH) është formuar trajta “përtac – *e*” *mb.* Që nuk ka dëshirë të punojë, që i pëlqem të rrijë pa punë, dembel; i ngathët ; *shurdhac* (nga folja me shurdhue) (FGJSSH); *grumbullac*² (nga folja me grumbullue) ; *gurmac* (FGJSSH) “gur i vogël i rumbullakët me të cilin lozin kalamajtë” ; *tarabac* (FGJSSH) : çun i vogël” (fjalë fëmijësh – hipokoristikë) ; *mundac* (FGJSSH) “ai që mundohet shumë e fiton pak”; *qullac* (FGJSSH) “lakror me preshe e me ve”; *shurdhac* (nga i shurdhër) etj.

Prapashtesa *-ec* për të cilën ka dëshmuar H. Bariqi³, po kështu na del si prapashtesë me origjinë sllsve. Nga kjo prapashtesë në shqipen kemi të formuara fjalët *librec* (nga libër); thumbec (FSH) “thumbi i ostenit”; *biralec* “lloj ëmbëlsire birabira”; *krypanec* (FSH) “lakror me hithra”. Me konglutiminin e prapashtesës – *alec* është formuar edhe trajta *bishtalec* (nga bisht); *barkalec – i* (nga barku) (FGJSSH); *kambalec* (nga kamb) (FGJSSH) etj.

Edhe prapashtesaa mbiemërore sllave *-av* u është bashkangjitur disa rrënjëve të fjalëve të shqipes dhe kështu janë krijuar fjalët diminutive të tipit: *ligavec*, *gungavec*, *burravec*, *frigavec*, *vjedhavec* (Gostivar) etj. Prapashtesa *-uc* në shqipen është me origjinë rumune nga *-ut*, si formant i përbashkët i latinishtes. Ajo më së tepërmi krijon emra të gjinisë mashkullore me kuptim emotiv. Formon kryesisht emra me kuptim zvogëluar nga emrat dhe aty-këtu edhe prej foljesh. Si të tillë mund të përmendim: *edhuc* (nga edh-i), *gjeluc* (nga gjel) (FGJSSH) “gjel i vogël”, *majuc* (nga majë-a,) (Strugë); *biruc* (nga vrima – birë-a) (Çegran – Gostivar). Autori ka nënvizuar edhe emrat diminutiv nga një rrënjë foljore, si:

¹ FGJSSH, Tiranë, 1980, f.1141

² Po ai, po aty, f.29.

³ Henrik Bariç, Hymje në historinë e gjuhës shqipe, Beograd, 1955.

ngrehuc, ngrehaluc - *i'* (nga f. ngre) (FGJSSH) “ njeri që kapardiset e shet mend; njeri që përpiqet të bjerë në sy me veshjen, me paraqitjen ose me mënyrat e jashtme.

Prapashtesa *-ik* i përket sfondit indoeuropian dhe kryesisht shërben për të formuar emra të prejardhur nga një emër. Si ië tillë autori ka përmendur: *dushnik -u* (nga dushk-u); *qafalik-u* (nga qafë-a) (FGJSSH).

Prapashtesa *-ok* është me origjinë shqipe dhe njaft prodhimtare edhe për emrat me kuptim zvogëlimi. Nga këtu edhe emrat përkëdhelës *bardhok* (nga. bardhë-a) *madhok* (nga i madh), *patok* (nga patë – a). Autori në vazhdim pohon se prapashtesat *-uk, -ok*, Norbert Jójki i nxjerr të ndërlihdura njëra me tjetrën dhe me origjinë latino – rumune. Ngjajshëm janë formuar edhe emrat diminutiv hipokoristik me *-lok*: *bablok* (nga baba) dhe *nanlokë* (nënë).

Prapashtesa *-kë (-ka)* është ndër prapashtesat tipike për ndërrim gjinie. Me të sajohen emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullorë. Si p.sh. *shqiptar – shqiptarkë, korçar – korçarkë, shkodran – shkodrankë*; nga *kopil – kopilkë*, nga *pllum – pllumkë* etj. Po kështu kjo prapashtesë me kuptim zvogëlimi na paraqitet edhe në shembujt: *vrimekë* (nga vrimë), *kambkë* (nga këmbë – a); *fletkë* (nga fletë – a); *dollapkë* (nga dollap i vogël), *shejtankë* (nga shejtani)

Prapashtesa *-ina* shërben po kështu për të formuar emrat me kuptim zvogëlime, edhe atë: *shpatinë, -na* (nga shpat –i) (FGJSSH) “shpat i vogël, faqe mali e vogë”; *mollçinë, -na* (nga mollë – a); *mjegullinë, -na* (nga mjegull); *dushkinë, -na* (nga dushk-u), etj.

Duhet të theksojmë se trajtat e dyta të emrave të formuara me anën e prapashtesave të zvogëlimit, lidhet ngushtë me zbulimin apo përkëdhelinë si dukuri me karakter gjuhësor e shoqëror. Një grup fjalësh zbuluese, ti cilat i përdorim kryesisht në ligjërimin familjar e në mjedise të ngushta shoqërore, janë formuar me prapashtesat zvogëluese, edhe atë: me prapashtesën *-ush*: *zemrush, babush, mamush*; *-ash*: *nipash*; *-çe*: *nipçe*; *-ko*: *dajko*.

Siç dihet, edhe te emrat e huaj të njerëzve që janë futur përmes ndikimit të feve të ndryshme (katolike, ortodokse e myslimane) gjejmë forma me prapashtesa zvogëluese a përkëdhelëse, si psh.: *Norushë* (< Nora), *Diluk* (< Dilë), *Prenash* (< Prend), *Alush* (< Ali), *Demush* (< Demë<Adem), *Hajrush* (< Hajro), *Stefanaq* (< Stefan), *Nikollaq* (< Nikolla) etj.

Prapashtesa karakteristike zvogëluese e përkëdhelëse për formimin e trajtave të dyta të emrave vetjakë, janë edhe ato që ka evidentuar profesor Gjovalin Shkurtaj². Me prapashtesën *-aç*: *Rrokaç* (nga Rrok), *Miraç – i* (nga Mirash me kalim të *sh* në *ç* ose me *-aç* nga Miro). Me prapashtesat: *-aqe*: *Prenaqe-ja*; *-et*: *Lule*: *t* (nga Lul <Lulash), *Preçet* (Preç < Preçoç); *-oç*: *Preçoç-i* (Prek); *-oc*: *Preloc* (nga Prel); *-ot*: *Malot, Markot, Prelot*.

Me prapashtesën *-uk* takojmë trajtat *Diluk-a, Maruk-a* (nga Dilë e Marë); *--al-ush*: *Makalush*; *-ulo*: *Hanulo* (nga Hanë), *Pretulo* (nga Prend).

Me ca prapashtesa zvogëlimi mund t'i gjejmë të formuara edhe disa toponime në mbarë hapësirën shqiptare, ku veçojmë këto prapashtesa: *-z(ë)*: *Arrëza, Kodërza* (Gradec- Gostivar); *-ishte*: *Ahishte, Barishte* (Sërmnovë, Çegran – Gostivar) etj.

Nga sa u tha më sipër mund të përfundojmë se, trajtat e dyta të emrave që karakterizohen nga prapashtesave zvogëluese, kanë nevojë për hulumtim të mëtejshëm në mbarë hapësirën shqiptare. Kështu do të kontribuonim për t'u thelluar më tej në trajtimin e kësaj dukurie gjuhësore e shoqërore, të ndërlikuar e të vështirë, si dhe për të mbërritur në përfundime sa më të sakta për dukurinë në fjalë.

¹ FGJSSH, Tiranë, 1980, f.1250.

² Gjovalin Shkurtaj, Sociolinguistika, Tiranë, 1999, f.275

Bibliografia

- Henrik Bariç, Hymje në historinë e gjuhës shqipe, Beograd, 1955.
Vojislav Dançetoviq, Sufiksi diminutiv i emnave të gjuhës shqipe, Prishtinë, 1960.
Gjovalin Shkurtaç, Onomastikë dhe etnolinguistikë, Tiranë, 2001.
Gjovalin Shkurtaç, Sociolinguistika, Tiranë, 1999.
Gjovalin Shkurtaç, Etnografi e të folurit të shqipes, Tiranë, 2004.
FGJSSH, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1980.